



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Prishtina –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 04/L –144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 3.2 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

## V E N D I M

### **PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS AMBASADËS SË GJERMANISË NË KOSOVË**

- I.** **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcelat kadastrale nr. 2721-5, sipërfaqe prej 1075 m<sup>2</sup>, 2719-2, sipërfaqe 722 m<sup>2</sup>, 2805-10, sipërfaqe 5465 m<sup>2</sup> dhe parcela 3004-4, sipërfaqe 1499 m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, “Pasuri Shoqërore, Kuvendi Komunal Prishtinë”.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit për nevojat e Ambasadës së Gjermanisë.
- IV.** Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, për 99 vjet.
- V.** Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:
  - skica grafike,
  - kopja e planit dhe certifikata e pronës.



- X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-462/01-0290905/18, më 10.12.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

